



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
SPITALI RAJONAL DURRËS  
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr.Prot \_\_\_\_\_

Durrës, me \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2018

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[06.06.2018]

Për: “ALB-Siguracion” Sh.a me NIPT K42108801C dhe adresa Tirane TIRANE Rruga George W. Bush

Procedura e prokurimit: **Kerkese per Propozim**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-64901-04-24-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]:

[“Sigurimi I Ndertesave, Inv Ekonomik, Paisje Informatike Te Spitalit Rajonal Durres dhe kohëzgjatja e kontratës Sigurim 12 (dymbëdhjete ) muaj ose 1 (nje) vit nga data e nënshkrimit te kontrates/

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [30.04.2018], [Numri 17]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme  
Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë një ofertues me vlerën përkatëse të ofruar:

Public Health Sector

1. ALB-Siguracion

K42108801C

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **2 490 400** (dymilion e katerqind e nentedhete mije e katerqind) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë)

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

1 . ALB-Siguracion

K42108801C

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Ne KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT te DST nendarja 2 e pikes 2.3 eshte kerkuar ne menyre te specifikuar “Ofertuesi duhet te kete kontrate risigurimi per periudhen kohore ne te cilen ofertuesi merr persiper sigurimin e demit qe kerkohet ne kete procedure prokurimi” ndersa nga ana e operatorit ekonomik eshte paraqitur vetem dokumenti:

KONFIRMIM GARANCIE date 26.01.2018, per risigurimin e demeve, me afat nga data

01.01.2018 deri me 31.12.2018.

Ankesa: **ka patur**

\*\*\*

Nga ana e operatorit ekonomik "ALBSIG" Sha me daten 18.05.2018 me nr.826 prot eshte paraqitur ***Shtojca 21 Formulari i Ankeses prane Autoritetit Kontraktor Spitalit Rajonal Durres***, e protokolluar me tonen nr.1404 prot date 18.05.2018, i cili ka kundërshtuar piken 2 te nendarjes 2.3, ne seksionin konkretisht kriteret e Kapacitetit Teknik ku kerkohet qe:

1. *Ofertuesi duhet te kete kontrate risigurimi per periudhen kohore ne te cilen ofertuesi merr persiper sigurimin e demit qe kerkohet ne kete procedure prokurimi.*

Duke parashtruar argumentin se operatori ka patur kontrate risigurimi per te gjithe vitin kalendarik 01.01.2018 – 31.12.2018 dhe se kontrata e risigurimit hartohen dhe nenshkruhen mbi baze viti kalendarik kerkon :

- 1) **Rivleresimin e vendimit per mosklasifikimin e ofertes tone, pasi argumentet e provat e parashtruara prej nesh, shpresojme t'ju bindin per drejtesine e ankimit tone; dhe**
- 2) **Pranimin e ofertes se Albsiguracion sha per tenderin me objekt Sigurimi i Ndertesave, Inv Ekonomik, Pajisje Informatike te Spitalit Rajonal Durres me fond limit 2.492.181 Leke pa TVSH**

- **Komisioni Posacem i Shqyrtimit te Ankesave mbeshtetur ne te gjithe praktiken e prokurimit me objekt "Sigurimi i Ndertesave, Inv Ekonomik, Pajisje Informatike te Spitalit Rajonal Durres" me fond limit 2.492.181 Leke pa TVSH", legjislacionin ne fuqi argumenton:**

1. Si nje e drejte e parashikuar ne piken 1 dhe 5 te Nenit 78 te VKM Nr. 914 date 29.12.2014 **Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me Vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 me Vendimin Nr.797, datë 29.12.2017 dhe me vendimin nr. 80 datë 14.02.2018**, ankesa e paraqitur nga Subjekti "ALB-Siguracion" Sha me nr. 1404 prot date 18.05.2018 e protokolluar me tonen nr. 1404/1 prot date 21.05.2018 eshte depozituar brenda afatit 7 ditor dhe si e tille duhet te shqyrtohet.

2. Ne zbatim te nenit 46 te LPP pika b) aftesia teknike dhe pikes 5 te nenit 28 te VKM Nr. 914: autoriteti kontraktor ka te drejte te kerkoje qe operatori ekonomik nder paisjet dhe materialet teknike qe disponon, ti vertetoj se ka reputacionin dhe besueshmerine, duke paraqitur deshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ai vete apo qe mund ti vihen ne dispozicion per te zbatuar kontraten. Si e tille shikohet me vend dhe brenda kriterëve kerkesa e autoritetit kontraktor per te kerkuar nga operatori ekonomik, qe ky i fundit me qellim sigurimin e demit dhe permbushjen e kontrates te kete kontrate risigurimi per te gjithe periudhen kohore qe operatori ekonomik merr persiper te siguroje demin. Dhe me kerkesen e tij nuk i referohet vetem periudhes kohore gjate seciles zhvillohet procedura e prokurimit deri ne momentin e nenshkrimimit te kontrates, por te gjithe periudhes kohore te parashikuar ne seksionin 2 "Objekti i kontrates" pika 2.9 e DST-se ku eshte percaktuar "**12 muaj nga koha e nenshkrimimit te kontrates**".

3. Duke shqyrtuar kriteret e percaktuara ne Ligjin Nr.52/2014 "Per veprimtarise e sigurimit dhe risigurimit" neni 116 percakton detyrimin se "**Shoqëria e sigurimit është e detyruar të risigurojë në një shoqëri risigurimi pjesë e rreziqeve të siguruara që tejkalojnë mbulimin**

*maksimal, sipas përcaktimeve të këtij neni*". Legjislacioni në fuqi nuk përcakton limite lidhur me afatin e vlefshmerisë së ketyre kontratave të risigurimit, duke i lënë ato në vlerësimin fakultativ të shoqërive siguruese.

Por nga ana tjetër, përcakton menyrat dhe mjetet me të cilat kontrollojnë shoqëritë siguruese lidhur me sigurimin e detyrimeve që ato marrin persiper. Konkretisht, referuar përcaktimeve të dispozitës 117 të Ligjit nr. 52/2014 ku përcaktohet:

*"1. Shoqëria e sigurimit, për çdo vit financiar, harton dhe zbaton programin e nevojave për risigurim, në varësi të strukturës së portofolit të sigurimit, si dhe përcakton marrëveshjet e risigurimit, sipas të cilave ajo duhet të sigurojë tejkalimin e mbulimit maksimal të rreziqeve"*

*5. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet programin e planifikuar të risigurimit, jo më vonë se 60 ditë kalendrike para mbylljes së vitit financiar.*

*6. Autoriteti, pasi shqyrton programin e planifikuar të risigurimit, jep opinion brenda 45 ditëve kalendrike nga data e depozitimit të informacionit të plotë në Autoritet.*

*7. Autoriteti mund të përcaktojë rregulla të mëtejshme për përmbajtjen e programit të risigurimit, afatin e depozitimit të tij, si dhe kriteret për vlerësimin e programit.*

Per sa ka parashikuar edhe Rregullorja për Kriteret e Rivlerësimit të AMF-së, neni 3/1 Kriteret e Përgjithshme "Shoqëria e sigurimit, për çdo vit financiar zbaton programin e nevojave për risigurim të mbështetur në vlerësimin e rreziqeve që parashikon të marrë në sigurim në baza individuale nga vetë shoqëria, si edhe nëpërmjet përfshirjes së saj në bashkësigurime apo krijimit të grupimeve të veçantë për mbulimin e rreziqeve të mëdha" dhe neni 6 i saj Shqyrtimi i Kontrates së Sigurimit, sipas të cilave është rregulluar pozicioni kontrollues i AMF-së dhe vërehet qartë elementi vjetor i marrdhenies së risigurimit të shoqërive siguruese, mbi bazën e plan veprimit individual të vet shoqërive të vlerësimit të rreziqeve të marra persiper.

4. Gjithashtu Komisioni Posacem i Shqyrtimit të Ankesës mori në shqyrtim edhe dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik, konkretisht bilancet e këtij të fundit, xhiron vjetore dhe ato mesatare të realizuar gjatë tre viteve të fundit, e cila i mbulon dhe tejkalon përcaktimet ligjore. **License për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit Nr.10/2004 date 22.06.2012**, nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, e cila është pa afat dhe ate të vlerësuesit të demit License për ushtrim Veprimtarie Vlerësues Demesh në Sigurime Nr.106 date 31.10.2014 e specialistit për demë Z. Shefqet Ahmeti, me afat 5 vjet me të drejtë rinovimi të leshuara nga AMF-ja Tirane.

## PËR KËTO ARSYE

Komisioni Posacem i Shqyrtimit të Ankesës, në zbatim të gërmes ç) pika 6 e nenit 78 të VKM Nr. 914 date 29.12.2014 i ndryshuar.

## VENDOSI:

- Ankesa e operatorit ekonomik, shoqërisë tregtare "ALB-Siguracion" Sha nr.1404 date 18.05.2018, është e drejte.

\*\*\*

**Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bazuar në Vendimin Nr. 1404/2 prot date 24.05.2018 të Komisionit të Posacem të Shqyrtimit të Ankesës, pasi rivlerësoj**

**dokumentacionin e ofertes te paraqitur nga operatori ekonomik ALB-Siguracion Sha, i konsideroi ato te rregullta dhe vendosi ta kualifikoj kete operator ekonomik duke e shpallur fitues.**

**\* \* \***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **ALB-Siguracion” Sh.a me NIPT K42108801C dhe adresa Tirane TIRANE Rruga George W. Bush** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **[2 490 400 (dymilion e katerqind e nentedhete mije e katerqind) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë) lekë pa TVSH ]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **[Spitali Rajonal Durrës, me NIPT K42311504G, me adresë Rr.”A.Goga”, L.Nr.8, Durrës, Tel/Fax+355 52-221-58 +355 52-23358;E-mail [sekretaria@srd.gov.al](mailto:sekretaria@srd.gov.al)]** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **07.05.2018**



**TITULLARE E AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Dr. Nadire JANI**